



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 363 Prot.

Tiranë, më datë 29.04.2022

VENDIM

Nr. 128, datë 29.04.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj” si dhe të VKM Nr. 1040, datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kritereve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje”, pas shqyrtimit më parë të kërkesës së Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Drejtoria Vendore Tirana Veri me Nr. 1495 Prot., datë 11.02.2022, administruar në Sekretarinë Teknike të IKTK-së me Nr. 101 Prot., datë 14.02.2022 në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 29.04.2022:

VENDOSI:

1. Vijimin e procedurës së legalizimit të një ndërtimi informal me vetëdeklarues z. *Maliq Hasmuça, Pavllo Naumi, Bari Hado, Shefqet Zani, Aleksandër Hoxha, Bedri Kraja, Haxhi Subashi, Stefan Komino, Zyhdi Baçova*, në Tiranë, në objekt Monument Kulture Kategori e II, me emërtim “Banesë kolektive 6 kate, Rruga “Dedë Gjon Luli”, shpallur me Urdhër të Ministrisë të Kulturës Nr. 276, datë 16.07.2015.
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
3. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR

Rudina ZOTO

